

KARTELE INFORMATIVE

AL013002

1. Emri i shërbimit	Leje pune për punë stinore (A/PS)			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Ky shërbim vlen për të certifikuar rregullsinë e punësimit të punëmarrësit në vendin ku do të punojë			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Ky shërbim ofron lejen e punës për punëmarrësit që duan të punojnë në Republikën e Shqipërisë për punë stinore			
4. A jam përfitues?	Të gjithë shtetasit e huaj, me përjashtim të: shtetasve të Bashkimit Europian, shtetasve të huaj të zonës Shengen dhe shtetasve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit me nënshtetësi shqiptare të Republikës së Serbisë			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Formulari me të dhënat e aplikantit	Institucioni	Po
	2	Kopjen e kontratës individuale të punës	Noteri/ Palët në marrëveshje	Po
	3	Fotokopje pashaporte	Aplikanti	Po
	4	Autorizimin nga punëdhënësi (për personin e autorizuar)	Punëdhënësi aktual	Po
	5	5 (pesë) fotografi	Aplikanti	Po
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
	Sporteli i ADISA; Zyrën përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës punëdhënësi, pranë të cilit do të punësohet i huaji, ushtron veprimtarinë ekonomike; Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, nëse punëdhënësi, pranë të cilit do të punësohet i huaji, e ushtron veprimtarinë ekonomike në më shumë se një rajon gjeografik; Përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e tij të origjinës ose në përfaqësinë diplomatike që mbulon vendin e origjinës së të huajit	Sporteli i ADISA në Maliq, Belsh dhe Patos; Zyra e Punësimit në qytetin përkatës; Tiranë; Përfaqësitë diplomatike në vendin e origjinës së të huajit	Në të gjitha sportelet ADISA Maliq, Belsh dhe Patos; Zyra e Punësimit në qytetin përkatës; Bulevardi "Bajram Curri" pranë ish hotel Arbana; Përfaqësitë diplomatike në vendin e origjinës së të huajit	ADISA: E hënë- E premte ora 08:00- 15:00; SHKP: E hënë- e enjte ora 08:00- 16:30; E premte, ora 08:00- 14:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
	Ofrohet informacion mbi shërbimin	Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Shërbimi ofrohet tërësisht online
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Mënyra e pagesës
	6 000 lekë	Nuk ka		Në një bankë (ose në disa banka), jashtë institucionit
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	30 ditë			
10. Çfarë përfitoj?	Lejen e punës			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	Deri në 6 muaj (për çdo vit kalendarik)			
12. Ku e marr?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input type="checkbox"/>	E-albania <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontakto në:		Orari	
	E- albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al SHKP web: www.shkp.gov.al Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118		Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E Hënë- E Premte, ora 08:00- 19:00	
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input type="checkbox"/>	Web-i i Institucionit <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
	Në platformën "Shqipëria që duam" Link: www.shqiperiaqeduam.al		<input checked="" type="checkbox"/>	

16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?

*Ligji Nr. 108/2013 datë 28.03.2013, "Për të huajt", i ndryshuar
VKM Nr. 75, datë 12.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës, si punëtor stinor, të tipit 'A/PS'*